



Република Северна Македонија

Министерство за финансии

Ministria e Financave në bazë të nenit 22 paragrafi (1) alineja 2 dhe alineja 5, paragrafi (3), paragrafi (4) dhe paragrafi (8) të Ligjit të Punësuarve në Sektorin Publik (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, numër 27/14, 199/14, 27/16, 35/18 dhe 198/18, si dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” numër 143/19, numër 14/20 dhe numër 208/24), nenit 22 paragrafi (1) pika 1), nenit 23, nenit 24, nenit 25, nenit 26 dhe nenit 27 të Ligjit të Marrëdhënieve të Punës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 62/05, 106/08, 161/08, 114/09, 130/09, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15, 27/16 dhe 120/18, si dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” numër 110/19, 267/20, 151/21, 288/21 dhe 111/23) dhe Rregullores së sistematizimit të vendeve të punës në Ministrinë e Financave, publikon

SHPALLJE NUMËR 11/2024 PËR PUNËSIM NË MINISTRINË E FINANCAVE

I.Ministria e Financave publikon shpallje për punësimin e 2 (dy) personave me kohë të caktuar, për shkak të rritjes së vëllimit të përkohshëm të punës, për periudhë prej një viti, respektivisht në këto vende të punës:

1. Bashkëpunëtor i lartë i analizave dhe projeksioneve të zhvillimeve makroekonomike, Njësia e Modeleve dhe Projeksioneve Makroekonomike, Sektori i Politikës dhe Zhvillimit Makroekonomik – (1 realizues);

Kualifikimet e nevojshme:

- të ketë fituar të paktën 180 kredi sipas SETK-së ose ta ketë përfunduar shkallën VII/1 në fushën e shkencave shoqërore – ekonomi dhe biznes;
- së paku dy vjet përvojë pune në profesion;
- njohuri aktive të njërës prej tri gjuhëve më të përdorura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht);
- njohuri aktive të programeve kompjuterike për punë zyre;
- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut;

Orari i punës:

- orari ditor i punës me fillim nga ora 7:30 dhe 8:30 dhe përfundimi i orarit ditor nga ora 15:30 dhe 16:30, orari javor i punës 40 orë – nga e hëna deri të premten.

Paga themelore neto: 32.332,00 denarë.

2. Referent i pavarur për punë në zyrë, arkiv dhe arkë, Njësia Rajonale e Procedurës Administrative në Shkallën e Parë – Strumicë, në Sektorin e Procedurës Administrative, Drejtoria e Çështjeve Pronësore dhe Juridike – (1 realizues);

Kualifikimet e nevojshme:

- arsim të lartë/të mesëm të gjimnazit dhe/ose arsim të mesëm profesional;
- së paku tre vjet përvojë pune në profesion;



Република Северна Македонија

Министерство за финансии

- njohuri aktive të njërës prej tri gjuhëve më të përdorura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht);
- njohuri aktive të programeve kompjuterike për punë zyre;
- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut;

Orari i punës:

- orari ditor i punës me fillim nga ora 7:30 dhe 8:30 dhe përfundimi i orarit ditor nga ora 15:30 dhe 16:30, orari javor i punës 40 orë – nga e hëna deri të premten.

Paga themelore neto: 25.831,00 denarë.

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dëshmi për plotësimin e kushteve të cilat kërkohen për vendin e punës për të cilin aplikojnë, përkatësisht: biografi të shkurtër – CV, detyrimisht me kontaktin e telefonit dhe adresën; fotokopje të dëshmisë për nivelin e përfunduar të arsimit për vendin e punës që kërkohet; vërtetim nga FSPI-ja, vërtetim nga Agjencia e Punësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut si dëshmi për përvojën e kërkuar të punës; fotokopje e certifikatës së shtetësisë; fotokopje si dëshmi për njohjen e njërës prej tri gjuhëve më të përdorura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht) dhe fotokopje të dëshmisë për njohjen e programeve kompjuterike për punë zyre.

II. Ministria e Financave publikon shpallje për punësimin e 1 (një) personi me kohë të caktuar, për punë me projekte, për periudhë prej pesë vitesh, respektivisht në këtë vend të punës:

1.Kujdestar/e, Njësia Projektuese për Kujdesin dhe Edukimin e Fëmijëve në Moshën Parashkollore – Kopshti i Fëmijëve (1 realizues/e);

Kushtet e përgjithshme që duhet t'i plotësojnë kandidatët:

- të jetë shtetas/e i/e Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- të jetë i/e shëndoshë fizikisht dhe psikikisht;
- të ketë njohuri të gjuhës maqedonase dhe alfabetit cirilik;
- të mos i jetë shqiptuar dënim me aktgjykim të plotfuqishëm për ndalesë të ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- të mos i jetë shqiptuar dënim me aktgjykim të plotfuqishëm për veprën penale të dhunës në familje, marrjes pa leje të të miturit, neglizhencës ose abuzimit me të miturin ose incestit, për veprën penale nga grupi i veprave kundër lirisë gjinore, pavarësisht sanksionit të shqiptuar dhe tek i cili është konstatuar sjellje diskriminuese në përputhje me ligjin.

Kushtet e veçanta që duhet t'i plotësojnë kandidatët:

- shkollë të mesme katërvjeçare: shkolla e mesme e mjekësisë - drejtimi i përgjithshëm, arsimit i mesëm - drejtimi i gjimnazit, shkolla e mesme e muzikës, shkolla e mesme e artit ose shkolla e mesme e edukimit fizik;
- me ose pa përvojë pune në këtë profesion;



Република Северна Македонија

Министерство за финансии

- licencë të vlefshme si kujdestar/e.

Orari i punës:

- orari ditor i punës me fillim nga ora 7:30 dhe 8:30 dhe përfundimi i orarit ditor nga ora 15:30 dhe 16:30, orari javor i punës 40 orë – nga e hëna deri të premten.

Paga themelore neto: 24.728,00 denarë.

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dëshmi për plotësimin e kushteve të cilat kërkohen për vendin e punës për të cilin aplikojnë, përkatësisht: biografi të shkurtër - CV detyrimisht me kontaktin e telefonit dhe adresën; fotokopje të dëshmisë për shkallën e përfunduar të arsimit për vendin e punës që kërkohet; vërtetim nga Agjencia e Punësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut si dëshmi për përvojën e kërkuar të punës; fotokopje të licencës përkatëse që kërkohet për vendin e punës; fotokopje të certifikatës së shtetësisë; fotokopje të vërtetimit të mjekësisë së punës si dëshmi e aftësisë shëndetësore në përgjithësi për vendin e punës; vërtetim nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut si dëshmi se nuk i është shqiptuar sanksion për ndalesë të ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës; si dhe vërtetim nga evidenca penale i lëshuar nga Gjykata Themelore si dëshmi se kundër personit nuk është ngritur procedurë penale, as nuk është shqiptuar aktgjykim për vepër të kryer penale.

Dokumentacioni i nevojshëm duhet të dorëzohet në zarf të mbyllur në këtë adresë:

**Ministria e Financave
rr. "Dame Gruev" nr. 12, 1000 Shkup
(me shënim "për shpallje punësimi")**

Në zarf të shënohet numri i shpalljes dhe numri i vendit të punës për të cilin aplikon, me shënimin: "Mos e hap".

Afati për dorëzimin e dokumentacionit të nevojshëm është 3 (tri) ditë pune, duke përfshirë ditën e publikimit të shpalljes në gazetata ditore.

Fletëparaqitja dhe dokumentacioni me vonesë, i paplotësuar dhe i pakompletuar nuk do të shqyrtohet.

Pas shqyrtimit të fletëparaqitjeve të dorëzuara, kandidatët të cilët kanë dokumentacion të rregullt do të thirren për përzgjedhje shtesë në hapësirat e Ministrisë së Financave.

Ministria e Financave do të kryejë përzgjedhjen në afatin e përcaktuar sipas nenit 23 paragrafi (2) të Ligjit të Marrëdhënieve të Punës.

Personat kontaktues:

Verica Stoilova - tel. 02/ 3255 619; verica.stoilova@finance.gov.mk

Kimet Kurtishi - tel. 02/ 3255 634; kimet.kurtisi@finance.gov.mk